

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2018

Tiranë, më 23 Janar 2019: Publikimi “Lëvizjet e Shtetasve në Shqipëri” ka për qëllim matjen e disa treguesëve statistikore që lidhen me turizmin. Të dhënat administrative sigurohen nga Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit dhe janë subjekt i revizionimit të vazhdueshëm. Si pasojë e fluksit të shtuar në pikat kufitare gjatë sezonit turistik, krijohen diferenca statistikore midis hyrje-daljeve në kufi, dhe autoritetet bazuar në ligj nuk regjistrojnë të gjithë shtetasit në hyrje. Për më shumë informacion konsultohuni me shpjegimet metodologjike në faqen 4.

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Dhjetor 2018, janë 833.200, krahasuar me Dhjetor 2017, ky tregues rezulton me rritje 12,3 %.


Në Dhjetor 2018, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 280.699. Krahasuar me Dhjetor 2017, ky numër është rritur me 9,0 %.

Hyrjet e shtetasve të huaj në vendin tonë në vitin 2018, janë 5.926.803 duke u rritur me 15,8 %, në krahasim me vitin 2017.

Në Dhjetor 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Greqia ka patur rritjen më të madhe me 86,2 %, dhe uljen më të madhe e kanë pasur shtetasit nga Polonia me 32,2 %.

Në 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka pasur rritjen më të madhe 34,2 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Dhjetor 2018, janë 655.415 duke shënuar një ulje me 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2018, janë 446.032. Krahasuar me Dhjetor 2017, ky numër është rritur 11,7 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Dhjetor 2018, janë 209.383. Krahasuar me Dhjetor 2017, ky numër është ulur 23,5 %.

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i vendit tonë në 2018, janë 5.415.071, duke u rritur 4,4 %, krahasuar me një vit më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2017	Janar-Dhjetor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	741.685	833.200	12,3	9.969.322	11.246.520	12,8
Shqiptarë	484.211	552.501	14,1	4.851.622	5.319.717	9,6
Të Huaj	257.474	280.699	9,0	5.117.700	5.926.803	15,8
Dalje gjithsej	673.013	655.415	-2,6	10.419.480	11.432.521	9,7
Shqiptarë	399.137	446.032	11,7	5.186.100	5.415.071	4,4
Të Huaj	273.876	209.383	-23,5	5.233.380	6.017.450	15,0

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Ndryshim vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2017	Janar-Dhjetor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	53.837	74.616	38,6	1.745.973	2.088.503	19,6
Maqedoni	67.350	40.676	-39,6	671.570	680.780	1,4
Greqi	29.105	54.203	86,2	489.172	552.638	13,0
Itali	28.129	28.384	0,9	363.344	436.103	20,0
Angli	6.514	7.772	19,3	127.333	126.296	-0,8
Mali i zi	27.022	26.773	-0,9	380.988	357.071	-6,3
Poloni	671	455	-32,2	114.582	153.718	34,2
SHBA	3.917	4.078	4,1	97.786	116.978	19,6
Spanjë	645	631	-2,2	22.099	24.675	11,7
Gjermani	5.019	4.895	-2,5	121.604	142.291	17,0
Zvicër	2.433	2.958	21,6	54.051	54.869	1,5
Të tjera	32.832	35.258	7,4	929.198	1.192.881	28,4
Gjithsej	257.474	280.699	9,0	5.117.700	5.926.803	15,8

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periodha	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Dhjetor 2017	Janar-Dhjetor 2018	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	257.474	280.699	9,0	5.117.700	5.926.803	15,8
I. Personale	252.240	274.079	8,7	5,049,173	5,839,626	15,7
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj	233.990	253.301	8,3	4.865.841	5.639.818	15,9
2. Trajtim shëndetësor	19	34	78,9	634	276	-56,5
3. Qëllime fetare	29	54	86,2	601	778	29,5
4. Udhëtarë transit	18.202	20.690	13,7	182.097	198.754	9,1
II. Biznes dhe profesionale	5.234	6.620	26,5	68.527	87.177	27,2

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periodha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Dhjetor - 2017	114.992	50.885	575.808	104.855	24.350	543.808
Dhjetor- 2018	121.666	55.457	656.077	105.352	25.845	524.218
Ndryshimi vjetor (%)	5,8	9,0	13,9	0,5	6,1	-3,6
Janar-Dhjetor 2017	1.305.953	755.346	7.908.023	1.336.259	780.314	8.302.907
Janar-Dhjetor 2018	1.474.562	799.136	8.972.822	1.485.049	794.755	9.152.717
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	12,9	5,8	13,5	11,1	1,9	10,2

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimit në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të atktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.